



Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) mbështetur nga Projekti i përbashkët i Këshillit të Evropës/BE kundër Krimit Ekonomik (PECK III) në kontekst të zbatimit të aktivitetit “Zhvillim i Programit Trajnues dhe Trajnim për Trajner në lidhje me Mbrojtjen e Sinjalizuesve” dhe në harmoni me Udhëzimin Administrativ (QRK) - Nr. 13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në Institutin e Kosovës për Administratë Publike shpall:

## THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët kanë njohuri substanciale në legjislacion, procedura administrative, parandalim të korrupsionit dhe/apo politika kundër korrupsionit dhe shkathtësi për ligjërime, të aplikojnë për ligjërues/trajnerë të ardhshëm për zbatim të këtij programi:

### **Trajnim për Trajnerë (TpT): Trajnim për trajner për të drejtat e sinjalizuesve**

Programi do të përfshijë pjesën teorike dhe praktike lidhur me kornizën ndërkombëtare dhe vendore duke përfshirë praktikën më të mirë dhe mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Qëllimi i këtij programi është që të rritë kapacitetet e zyrtarëve dhe të krijoj nga ta një grup trajnerësh të cilët do të mund të bartin njohuritë e zyrtarëve e institucioneve publike në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesve.

Në fund të procesit, pritet që trajnerët të jenë në gjendje të ofrojnë trajnime për temën e sinjalizimit duke përdorur programin dhe materialet e hartuara vetë ose të siguruar nga projekti.

### **Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit**

Programi i trajnimit për trajner do të zgjasë tri ditë. Pjesa e parë e trajnimit, konkretisht trajnimi për trajner, tentativisht do të mbahet me datat **26 deri 28 qershor 2021**. Ndërsa pjesa e dytë e trajnimit e cila edhe do të shërbejë për certifikimin e trajnerëve do të zgjasë 2 ditë dhe tentativisht do të mbahet me **15 dhe 16 shtator 2021**.

### **Vlerësimi i kandidatëve:**

Në harmoni me Udhëzimin administrativ të lartcekur, të gjithë kandidatët për trajnerë do të vlerësohen pas përfundimit të trajnimit.

### **Aplikacionet vlerësohen në bazë të kritereve si në vijim:**

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional;
- Përvoja e punës në fushën adekuatë;
- Përvoja në ofrimin e trajnimeve;

- Elementet tjera të meritës duke përfshirë hulumtimet dhe përvoja në fushën përkatëse.

### **Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:**

Aplikantët që do të rezultojnë të suksesshëm dhe në bashkëpunim me IKAP-in do të angazhohen si trajner sipas nevojave lidhur me programin specifik të trajnimit me mbrojtjen e sinjalizuesve.

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve: **1/03/2021 deri me 15/03/2021 në ora 24:00**. Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar.

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë vetëm **CV (formati Europass)** dhe një **letër motivimi** (deri në **250 fjalë, në formën bashkëlidhur**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe, në e-mail adresën: [Teuta.Kuqi.Maloku@rks-gov.net](mailto:Teuta.Kuqi.Maloku@rks-gov.net), duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

**Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në Aplikacionin tuaj mund të kërkohen për verifikim.**